



MË TË SIGURT PËR NË SHKOLLË

UDHËZIME PËR INSTALIMIN E PAJISJEVE URBANE DHE
PROJEKTIMIN ARKITEKTUROR TË ZONAVE TË TRAFIKUT PËR
PËRMIRËSIMIN E SIGURISË RRUGORE PËR FËMIJËT E SHKOLLËS



REPUBLIC OF SLOVENIA
MINISTRY OF INFRASTRUCTURE
SLOVENIAN INFRASTRUCTURE AGENCY

LUBJANË,
JUNE 2022

MË TË SIGURT PËR NË SHKOLLË

Udhëzime për instalimin e pajisjeve urbane dhe projektimin arkitekturor të zonave të trafikut për përmirësimin e sigurisë rrugore për fëmijët e shkollës

© Ministria e Infrastrukturës, Agjencia Sllovene e Infrastrukturës

Regjistri i katalogut të botimit (CIP) u përgatit në
Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare në Lubjanë

COBISS.SI-ID 140543747
ISBN 978-961-6191-24-1 (PDF)

Shënim për lexuesin

Është kënaqësia jonë t'ju paraqesim këtë botim të përkthyer të Udhëzuesit "**Më të Sigurtë për Shkollë**", që fokusohet në rregullat e trafikut në zonat e shkollave. Sekretariati i Përhershëm i Komunitetit të Transportit ka ndërmarrë përgjegjësinë e përkthimit të kësaj vepre në gjuhët e rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Nenjohim rëndësinë e këtyre udhëzimeve të cilat garantojnë sigurinë e komuniteteve tona, veçanërisht atë në zonat e rrugëve pranë shkollave. Merita për idetë u takon autorëve, përkushtimi i të cilëve i ka dhënë jetë këtij publikimi. Ne shprehim mirënjohjen tonë në mbajtjen e të drejtave të autorit që na kanë besuar përgjegjësinë për të sjellë punën e tyre në një audiencë më të gjerë.

Komuniteti i Transportit është një organizatë ndërkombëtare në fushën e lëvizshmërisë dhe transportit që ka 36 pjesëmarrës – vendet anëtare të Bashkimit Evropian të përfaqësuara nga Komisioni Evropian, gjashtë pjesëmarrësit e Evropës Juglindore dhe tre pjesëmarrësit vëzhgues. Ne po punojmë për integrimin e tregjeve të transportit të Ballkanit Perëndimor në BE duke ndihmuar partnerët e Ballkanit Perëndimor në miratimin dhe zbatimin e legjislacionit të BE-së në fushën e transportit si dhe mbështetjen e projekteve që lidhin partnerët rajonalë të Ballkanit Perëndimor mes tyre dhe me BE-në.

PËRMBAJTJA

DEKLARATA E EKSPERTIT.....	A	EKRANET LED PËR FËMIJË.....	25
LETËR MBËSHTETJEJE.....	B	EKRANET LED PËR ÇIKLISTË.....	26
LETËR MBËSHTETJEJE.....	C	KËRKESAT TEKNIKE PËR	
Qëllimi dhe parimet kryesore udhëzuese.....	D	EKRANET LED (PËR FËMIJË DHE ÇIKLISTË).....	27
Kërkesat e përgjithshme.....	E	NJOFTIME PËR PËRMIRËSIMIN E SIGURISË RRUGORE.....	28
TIPOGRAFIA DHE NGJYRAT.....	1	PËLHURAT.....	29
TIPOGRAFIA.....	2	PANKARTAT.....	30
NGJYRAT - RETROREFLEKTUESE.....	3	FLAMUJT.....	31
NGJYRAT - CMYK.....	7	AFISHETT.....	32
PAJISJET URBANE.....	9	SINJALISTIKAT E TESTIMIT TË AFTËSISË SË ÇIKLIMIT.....	33
PËRVIJUESIT ME NGJYRA.....	10	ETIKETAT NGJITËSE ME SHENJËN E AUTOBUSIT.....	35
SINJALIZIMI I ZONAVE SHKOLLORE.....	11	4 x P.....	36
ETIKETAT NGJITËSE PËR SINJALIZIMIN E RRUGËS.....	12	NDALOHEN TELEFONAT CELULARË.....	37
SINJALISTIKAT “FËMIJË NË RRUGË”.....	13	SINJALISTIKAT “BËHU I DUKSHËM”.....	38
SINJALISTIKAT PËR ÇIKLISTË.....	14	BËHU PËRDORUES I KUJDESSHËM I RRUGËS.....	39
SINJALISTIKAT E KËNDIT TË LOJRAVE.....	15	BËHU PËRDORUES I RESPEKTUESHËM I RRUGËS.....	40
SINJALISTIKAT PËR SHKALLËT.....	16	BËHU PËRDORUES TOLERANT I RRUGËS.....	41
SINJALISTIKAT KONTROLLOR TRAFIKU.....	17	JELEKËT E SIGURISË PËR FËMIJË.....	42
SINJALISTIKAT FËMIJË ME TULLUMBACE.....	18	SINJALISTIKAT E SILUETËS.....	43
SINJALISTIKAT PËR ECJE NË MAL DHE SKIATORË.....	19	SINJALISTIKAT “SHIKO”.....	44
SINJALISTIKAT PËR ZONËN E LËNIES DHE MARRJES SË FËMIJËVE.....	20	PROJEKTIMI I ZONAVE TË TRAFIKUT.....	46
SINJALISTIKAT PËR STACIONIN E AUTOBUSIT TË SHKOLLËS.....	21	PROJEKTIMI I ZONAVE TË TRAFIKUT NË	
SISTEMI AKTIV PËR SINJALISTIKAT E NDALESAVE TË		ZONAT SHKOLLORE.....	48
AUTOBUSIT TË SHKOLLËS.....	22	FORMAT, PËRMASAT, DHE PËRCAKTIMI I GRAFIKUT TË	
ORARET.....	23	NGJYRAVE RAL PËR TË APLIKUAR VIJËZIMET (DETAJET) NË	
SINJALISTIKAT “SHPEJTËSIA JUAJ”.....	24	KARREXHATË.....	53

DEKLARATA E EKSPERTIT

Qasja e Faktorit Njeri dhe Udhëzuesi Slloven për rrugë më të sigurt deri në shkollë

Qasja e Faktorit Njeri përpiqet të identifikojë mangësitë në "lexueshmërinë" ose "të kuptuarit intuitiv" të një pjese rrugore që mund të shkaktojë situata të rrezikshme apo edhe aksidente. Shumë gabime në drejtimin e automjeteve janë reagime të drejtuesve të automjeteve ndaj tipareve çorientuese të rrugës. Duke qenë se reagimi njerëzor është i pandryshueshëm, vëmendja duhet të përqendrohet në ergonominë e tipareve të rrugës. Prandaj është e domosdoshme të merren parasysh ligjet natyrore të perceptimit njerëzor, përpunimi i informatave dhe rregullimi i programeve të veprimit - kudo që siguria në rrugë paraqet problem.

Kjo vlen sidomos në rrugët për në shkollë, problem ky mbarëbotëror, ku drejtuesit duhet të jenë shumë të vetëdijshëm se fëmijët e shkollës mund të hyjnë papritur në rrugë. Kjo është arsyeja pse hapësira e rrugës duhet t'i udhëzojë drejtuesit e automjeteve se ata janë pranë një shkolle apo kopshti fëmijësh. Qëllimi është rritja e veçantë e vëmendjes dhe ndërgjegjësimit për drejtimin e mjetit në këtë segment rrugor, që nënkupton gatishmëri për frenim.

Si konkluzion, rruga duhet të projektohet dhe të pajiset në atë mënyrë që të ndjekë rregullin e Faktorit Njeri "Mos e befasoni kurrë drejtuesin e mjetit - ofroni mundësinë e zbulimit dhe reagimit të shpejtë dhe të sigurt". Por shumë shpesh shkollat, semaforët, vendkalimet, stacionet e autobusëve, korsitë e biçikletave dhe kalimi i tyre në rrugë shkrihen në mënyrë optike me sfondin. Pra, ato nuk janë shumë të dukshme dhe për këtë arsye shpesh nuk dallohen në kohë. Por, si mund të reagojë një drejtues nëse nuk mund ta dallojë dhe ta presë rrezikun?

Në nivel ndërkombëtar, janë bërë shumë prova për të rritur vëmendjen e drejtuesit dhe për të ngadalësuar shpejtësinë gjatë drejtimin pranë një shkolle ose një objekti tjetër për fëmijë. Por qasja e Udhëzuesit Slloven për rrugë më të sigurt deri në shkollë "MË TË SIGURT PËR NË SHKOLLË" e shtjellon këtë temë në mënyrën më të avancuar dhe inovative. Udhëzuesi

propozon përdorimin e objekteve që tërheqin vëmendjen dhe sinjaleve që dallohen nga distanca të gjata, me një konotacion të ngrohtë emocional në raport me fëmijët e shkollës. Rezultat i kësaj është një tërësi unike dhe shumë efektive e sinjaleve, shenjave, përvijuesve, shtyllave dhe vijëzimeve, që të gjitha së bashku janë në gjendje të udhëzojnë drejtuesin dhe të ndryshojnë programin pothuajse të automatizuar të drejtimin në një ngadalësim të vetëdijshëm.

Kombinimi i ngjyrave, madhësia e pajisjeve, qartësia grafike dhe larmia e kombinimit të elementeve mundësojnë një mjet efikas për të reduktuar gabimet e drejtimin dhe probabilitetin e situatave të rrezikshme. Veçanërisht efektivi për rritjen e vëmendjes dhe uljen e shpejtësisë, do të jetë kombinimi i tabelës së madhe sinjalizuese me dy fëmijët, përvijuesve të vegjël shumëngjyrësh dhe vijëzimeve në rrugë.

Uroj që ky udhëzues të ketë një aplikim dhe zbatim të gjerë për të përmirësuar ndërveprimin ndërmjet përdoruesve të rrugës dhe vetë rrugës me pajisje emocionale të ngrohta dhe vizuale që tërheqin vëmendjen. Uroj të përdoret gjerësisht në mbarë vendin për të tërhequr vëmendjen e drejtuesve të mjeteve që fëmijët e shkollës janë afër dhe t'i udhëzojë ata në mënyrë të pavetëdijshme madje që të ngadalësojnë shpejtësinë. Do të jetë një prej zgjidhjeve më të mira edhe në nivel ndërkombëtar.

Dr. S. Birtić

Psikologe Dr. rer. nat. Sibylle Birtić

Udhëheqëse e Grupit të Punës "Faktori Njeri në Projektimin dhe Caktimin e Kufijve të Besueshëm të Shpejtësisë" të Komitetit Teknik të PIARC C.2 "Projektimi dhe Funksionimi i Infrastrukturas më të Sigurt Rrugore".

LETËR MBËSHTETJEJE

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Pasi jam vënë në dijeni për mundësinë e prezantimit të masave të sigurisë rrugore “Më të sigurt për në shkollë”, me qëllim përmirësimin e sigurisë së fëmijëve, do të doja të jepja një deklaratë mbështetëse.

Duke qenë se kam pasur mundësinë që ta shqyrtoj qasjen e propozuar “Më të sigurt për në shkollë” në krahasim me mënyra të tjera për të rritur mbrojtjen e të miturve në rrugë, rezultatet, të paraqitura në punimin “Fëmijët - Disa çështje për përdorim më të mirë të kuptimit “fëmijë” në sistemin slloven të sinjalistikës rrugore për të rritur sigurinë rrugore të fëmijëve” sipas mendimit tim, duhet të justifikojë qartazi aplikimin e propozimit. Në shkurtesën e punimit të përmendur, “Më të sigurt për në shkollë” ka përparësi, të cilat ende nuk janë plotësuar nga masa të tjera, që kanë po të njëjtin synim.

Tiparet e paraqitjes grafike të simbolit të përdorur në sinjalistikën “Më të sigurt për në shkollë”, në krahasim me sinjalistikat e tjera që e rregullojnë këtë çështje, mbështesin më shumë dukshmërinë nga distanca më të mëdha (dallueshmërinë). Përmbajtja e imazhit të simbolit përdor hapësirën në dispozicion në dobi të saj, duke iu ofruar përdoruesve të rrugës kohë të përshtatshme për shikim gjatë drejtimit. Përmbajtja e imazhit të simbolit duhet të kuptohet lehtë si pamje e dy fëmijëve dhe të kuptohet pa ndonjë mëdyshje si paralajmërim i një pjese të rrugës ku prania e fëmijëve është e pritshme.

Forma e zgjedhur dhe kombinimi i ngjyrave për sinjalistikën janë shumë të dallueshme, gjë që mundëson që sinjali të vërehet herët dhe lehtë. Për më tepër, ky kombinim nuk përdoret qëllimisht në sistemin aktual të sinjalistikës rrugore të vendit dhe as nuk parashikohet në Konventën e Kombeve të Bashkuara për Sinjalistikat dhe Sinjalet Rrugore, të hartuar në vitin 1968. Kjo rrit edhe më tej dallueshmërinë, meqenëse ky kombinim është i ri, dhe shmanë përzierjen me sinjalistikat ekzistuese.

“Më të sigurt për në shkollë”, aplikon një qasje sistematike për të rritur vëmendjen me mjete të tjera përveç tërheqjes së vëmendjes në mënyrë të vetëdijshme, ashtu siç bën sinjalistika rrugore. Iniciativat e reja si kjo bazohen në ushtrimin e ndikimit në sjellje duke u përpjekur të zhysin drejtuesit në një mjedis të imponuar nga modelimi (“markimi”) i mjedisit të menjëhershëm përgjatë rrugës, duke krijuar kështu reagimin e dëshiruar nga ana e drejtuesve. Një qasje e tillë pritet të ketë potencialin e një efekti afatgjatë në sigurinë rrugore, në krahasim me mjete për tërheqjen e vëmendjes që duhet të ripërtërihen vazhdimisht për të mbetur funksionale.

Në mbështetje të “Më të sigurt për në shkollë”, shpresoj që kjo nismë të bëhet realitet duke u zbatuar në rrugë.

Sinqerisht,

Stefan Egger



LETËR MBËSHTETJEJE

Agjencia Slovene e Infrastrukturës përgatiti “Udhëzimet për instalimin e pajisjeve urbane dhe projektimin e zonave të trafikut për të përmirësuar sigurinë rrugore për fëmijët e shkollave”, duke propozuar parimet udhëzuese për dizajnet e shenjave rrugore që paralajmërojnë përdoruesit e rrugëve në afërsi të shkollave. Unë besoj se udhëzimet e hartuara mund të përmirësojnë dukshëm sigurinë rrugore të fëmijëve dhe prandaj mbështes zbatimin e tyre. Në vijim është dhënë një pasqyrë e shkurtër e arsyeve mbi të cilat bazohet mendimi im.

Udhëzimet përfshijnë parimet për një gamë të gjerë të sinjalistikës, që nga tabelat që tregojnë afërsinë e shkollës, e deri te vendkalimet e këmbësorëve afër shkollave, kufizimet e shpejtësisë, stacionet e autobusëve, tabelat që tregojnë pikën e lënies së fëmijëve të shkollës, afërsinë e shkollëve, këndeve të lojërave, çiklistëve në rrugë, e deri te jelekët dhe etiketat ngjitesë me dukshmëri të lartë. Për sa i përket sinjalistikës ekzistuese të qarkullimit, shenjat kanë dizajn të papërshtatshëm dhe janë të ngjashme në formë me personazhet nga letërsia për fëmijë. Seria e shenjave të propozuara kanë bazë të përbashkët të ngjyrave dhe dizajnit, imazhet dhe kombinimet e ngjyrave të tyre janë miqësore dhe mbartin një mesazh të qartë. Shenjat paraqesin fëmijë duke bërë diçka (duke i thënë mirupafshim një prindi në makinë, duke i dhënë biçikletës, duke ecur, duke pritur autobusin, etj.); ato paraqiten në mënyrë skematike, me kontraste të dallueshme ngjyrash, dhe nuk përmbajnë asnjë informacion të panevojshëm, duke paralajmëruar nga larg drejtuesit e mjeteve në mënyrë miqësore, dhe pa mëdyshje se ka fëmijë në afërsi dhe se duhet të jenë të kujdesshëm.

Këto karakteristika të dizajnit e bëjnë mesazhin të dallohet shpejt, pa pasur nevojë për përpjekje të veçanta për sa i përket perceptimit, gjë që në situatat e trafikut (p.sh. bllokime trafiku, shikueshmëri e reduktuar, etj.) është me rëndësi thelbësore për sigurinë e fëmijëve.

Një vlerë tjetër e rëndësishme e zgjidhjeve të propozuara të planifikimit hapësinor është fakti se koncepti jo vetëm që ofron një dizajn të ri grafik dhe hapësinor të sinjalistikës rrugore që tregon një zonë për fëmijë, por është një projekt që tashmë është testuar në formë pilot në rrugët e shkollave në komunën e Zhalecit në vitet 2015/2016; rezultatet e matjes së shpejtësisë në zonën e sinjalistikës së vijëzuar treguan qartë se shenjat e propozuara ishin efektive: sipas matjeve, shpejtësia e drejtimit të mjetit në vendet përkatëse ishte ulur dhe anketa pasuese tregoi se përdoruesit e rrugës u shprehën se sinjalet ishin të dukshme, të qarta, të komunikueshme dhe të pëlqyeshme.

Shenjat rrugore të propozuara nga udhëzimet duket se janë të dukshme, komunikuese, të dallueshme dhe miqësore, ashtu siç sugjerohet edhe nga rezultatet e studimit pilot. Prandaj, me arsye mund të pritet që të jenë efektive në qetësimin e trafikut rreth shkollave dhe kopshteve dhe të kontribuojnë në mënyrë thelbësore në sigurinë më të madhe të fëmijëve në trafik. Prandaj, unë mbështes dizajnin konceptual të propozuar nga udhëzimet dhe do të doja të shihja zbatimin e tyre në praktikë sa më shpejt të jetë e mundur.

Profesor Dr. Matej Svetina



Qëllimi dhe parimet kryesore udhëzuese

Si rregull, pajisjeve urbane dhe dizajnit të zonës së trafikut u kushtohet vëmendje kur drejtuesit e mjeteve nuk respektojnë ose nuk u përmbahen parimeve dhe rregullave të trafikut rrugor dhe kur shpejtësia dhe sjellja e drejtuesit të automjetit nuk i përshtaten trafikut dhe karakteristikave teknike të rrugës, anëve të rrugës dhe pranisë së përdoruesve të rrezikuar të rrugës.

Qëllimi i pajisjeve urbane, njoftimeve për të përmirësuar sigurinë e qarkullimit dhe dizajnit të zonës së trafikut është t'u ofrojë drejtuesve të mjeteve një paralajmërim miqësor për kufizimet e shpejtësisë ose për praninë e fëmijëve si përdorues të rrezikuar të rrugës.

Është provuar se pajisjet urbane dhe dizajni i zonës së trafikut kanë ndikim në vëmendjen e drejtuesit si dhe në mënyrën dhe shpejtësinë e drejtimit të automjeteve, duke qenë se psikologjia e trafikut merret parasysh në konceptin dhe dizajnin e tyre, krahas karakteristikave ose aftësive mendore dhe fizike të njeriut (të drejtuesve).

Masat urbanistike dhe arkitekturore për zbutjen e trafikut bëhen të dallueshme edhe për shkak të projektimit të tyre në vendet ku fushëpamja e drejtuesit është e mbingarkuar me informacione të tepërta.

Qetësimi i trafikut urban është hartuar në atë formë që të krijojë rrugë të vetë-shpjegueshme ose të parashikueshme në zonat ku ndodhen institucionet arsimore dhe të tjera të ngjashme me to, si dhe në rrugën për në shkollë, në zonat shkollore.

Masa të tilla u komunikojnë drejtuesve mesazhe me imazhin (dizajnin) e tyre dhe ofrojnë informacion të qartë lidhur me afërsinë e shkollave dhe praninë e fëmijëve në rrugë.

Për pasojë, drejtuesit përshtatin në mënyrë intuitive shpejtësinë dhe drejtimin e tyre me kushtet e rrugës. Kjo do të thotë që rruga ose pamja e saj, pra pamja e saj vetë-shpjeguese ose e parashikueshme, u tregon drejtuesve të përshtatin drejtimin e tyre në përputhje me rregullat e trafikut dhe në të njëjtën kohë i nxit ata (pra, i zgjon nga drejtimi monoton, meditativ ose i automatizuar) që të drejtojnë në përputhje me parimet e qarkullimit rrugor.

Në bazë të ligjit për rrugët, pajisjet urbane dhe projektimi i zonës së trafikut përbëjnë masa qetësuese të trafikut. Prandaj, zhvillimi i pajisjeve dhe zbatimi i masave për qetësimin e trafikut kërkojnë një dokument të planifikimit urban dhe trafikut, ku aksiomat e faktorëve njerëzorë në transport (dmth psikologjia e trafikut) merren parasysh në mënyrë profesionale dhe të paramenduar.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet njohjes dhe kuptimit të qarkullimit rrugor dhe ndikimit të masave të parashikuara tek drejtuesit e mjeteve.

Kodi i sjelljes profesionale dhe i përgjegjësisë së projektuesit janë faktorë shumë të rëndësishëm.

Përveç masave urbanistike dhe arkitekturore, udhëzimet ofrojnë edhe disa informacione për të përmirësuar sigurinë rrugore.

Sinjalet dhe pajisjet e trafikut nuk shfaqen ose përshkruhen shprehimisht në udhëzime. Ato rregullohen me Rregullat për sinjalizimin e trafikut dhe pajisjet në rrugë.

Pajisjet urbane dhe projektimi i zonës së trafikut nuk zëvendësojnë Rregullat për shenjat e komunikacionit dhe pajisjet në rrugë, por plotësojnë komunikimin vizual (drejtues-rrugë-anët e rrugës), përmirësojnë besueshmërinë e kufirit të shpejtësisë dhe tërheqin vëmendjen lidhur me praninë e fëmijëve në qarkullimin rrugor.

Kushtet e përgjithshme

Sipërfaqet e pajisjeve urbane dhe njoftimet për përmirësimin e sigurisë së trafikut duhet të bëhen nga materiale retroreflektuese, përveç:

- ngjyrës bazë të përvijuesit të ngjyrosur të sigurisë pasive (PSB) me diametër 160 mm,
- etiketës ngjitëse për sinjalizimin e rrugëve,
- tabelës së orarit të autobusëve,
- ekraneve LED,
- pëlhurës,
- pankartës,
- flamurit,
- afishes,
- Sinjalit “ndalo, shiko, dëgjo, mendo”,
- Sinjalit “ndalohen telefonat”,
- sinjalit “bëhu i dukshëm”,
- simbolit të jelekëve të sigurisë.

Pajisjet urbane dhe njoftimet për të përmirësuar sigurinë e trafikut janë të bëra nga materiale retroreflektive, me bazë të verdhë, dhe të stampuara (të stampuara në ekran ose të stampuara në formë dixhitale) në një fletë metalike me bazë të bardhë, retroreflektuese.

Pajisjet urbane nga materialet retroreflektuese ku ngjyra portokalli është ngjyra bazë e tabelës bëhen me stampimin e përmbytjes së tabelës në një fletë metalike me bazë të bardhë retroreflektuese, e cila më pas ngjitet në fletën/sipërfaqen retroreflektuese me ngjyrë portokalli.

Për projektimin e pajisjeve urbane dhe njoftimeve për përmirësimin e sigurisë rrugore, vlejné rregullat për shenjat e qarkullimit dhe pajisjet në rrugë apo standardi SIST EN 12899-1 (Sinalistika vertikale fikse të qarkullimit rrugor).

Gjatë projektimit të përvijuesit të ngjyrosur të sigurisë pasive me diametër 160 mm, duhet të merren parasysh kërkesat minimale të veçorive mekanike të tij:

1. Kushtet elementare

Sipas standardit SIST EN 12899-3, PSB-të* e ngjyrosur duhet të kenë karakteristikat vijuese:

- metoda e instalimit – lloji D3
- sipërfaqja retroreflektuese – klasa RA2,
- ngarkesa e erës – ËL1,
- rezistenca e sipërfaqes retroreflektuese ndaj goditjeve – DH1.

2. Kushtet shtesë

PSB-të e ngjyrosur duhet të ofrojnë një nivel të caktuar të sigurisë në rast të përplasjes me motoçikletë, dmth:

- **Nëse motoçiklisti godet PSB-në drejtpërsëdrejti:**

vlerat e parametrave të dëmtimeve/plagosjeve në kokë dhe qafë nuk duhet të tejkalojnë vlerat e parashikuara për dëmtimet e shkallës së dytë sipas SIST TS CEN/TS 17432:2019, me shpejtësi të goditjes deri në 30 km/h.

- **Nëse motoçiklisti godet PSB-në me gjoks:** deformimi kompresiv i gjoksit në kukullën standarde për testim, (mesatarisht 50% të gjatësisë për meshkuj – HYBRID III) nuk duhet të tejkalojë 33% me shpejtësi të goditjes deri në 70 km/h.

Përshtatshmëria e produktit duhet të dëshmohet me testim eksperimental apo me simulime numerike, të cilat realizohen nga personi apo institucioni i kualifikuar.

Rregullat për sinjalistikën e trafikut dhe pajisjet në rrugë gjithashtu vlejné, varësisht prej rastit, për instalimin e pajisjeve urbane dhe njoftimeve për të përmirësuar sigurinë në qarkullimin rrugor (distanca dhe lartësitë).

Nëse, për shkak të specifikës së rrugës dhe planimetrisë në anën e rrugës, shfaqet nevoja për tabela me përmasa që tejkalojnë 600 × 600 mm, mund të bëhet rritje proporcionale deri në 900 × 900 mm.

Pajisjet urbane që prodhohen si tabelë e transiluminuar u nënshtrohen po të njëjtave kushte si sinjalet e qarkullimit rrugor në përputhje me Rregullat për shenjat e trafikut dhe pajisjet në rrugë.

Përveç pajisjeve urbane, udhëzimet gjithashtu paraqesin njoftime për të përmirësuar sigurinë rrugore.

Të gjitha dimensionet e pajisjeve urbane dhe të njoftimeve janë dhënë në milimetra.

Gjatë projektimit të zonave të trafikut, karakteristikat e materialeve që përdoren për shenjat e rrugëve duhet të jenë në përputhje me dispozitat e SIST EN 1436 + A1 (Materialet e sinjalizimit të rrugëve – Performanca e sinjalizimit të rrugëve) dhe sipas kërkesave të specifikuara në vijim. Shenjat rrugore për zonat e trafikut aplikohen duke përdorur materiale më të holla ose më të trasha. Gjatë aplikimit, ose madje edhe në fazën e planifikimit, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet rëshqitshmërisë (SRT) dhe vetive reflektuese të shenjave, aty ku kërkohet.

Të gjitha dimensionet e shenjave arkitekturore jepen në metër.

Investitori është përgjegjës për mirëmbajtjen e rregullt të pajisjeve urbane dhe shenjave arkitekturore në përputhje me rregulloret dhe kodin e sjelljes profesionale, duke mundësuar kështu që projektimi urbanistik dhe arkitekturor t'i shërbejë vazhdimisht funksionit të trafikut rrugor.

* Përvijuesi i sigurisë pasive (Passive Safety Bollard)

TIPOGRAFIA
DHE NGJYRAT



TIPOGRAFIA

Tipografia e përdorur për shenjat që sinjalizojnë rrugët shkollore është **DIN Black**.

Përjashtim bëjnë **DIN Bold** dhe **DIN Regular** që përdoren për stampimin e orareve të autobusëve.

Madhësia e mbishkrimeve i përshtatet hapësirës në dispozicion.

Në asnjë rast shkronjat nuk duhet të deformohen përmes ngushtimit ose zgjerimit.



DIN Black

ABCČDEFGHIJKLMNOPQRSŠTUVWXYZŽ
abcčdefghijklmnopqrsštuvwxyzž
0123456789.,!?@#%&/()+-=-*>_€\${}§ß×÷

DIN Bold

ABCČDEFGHIJKLMNOPQRSŠTUVWXYZŽ
abcčdefghijklmnopqrsštuvwxyzž
0123456789.,!?@#%&/()+-=-*>_€\${}§ß×÷


DIN Regular

ABCČDEFGHIJKLMNOPQRSŠTUVWXYZŽ
abcčdefghijklmnopqrsštuvwxyzž
0123456789.,!?@#%&/()+-=-*>_€\${}§ß×÷

NGJYRAT - RETROREFLEKTUESE

PANELET INFORMATIVE DHE PAJISJET E PRODHUARA NGA MATERIALET RETROREFLEKTUESE

E BARDHA dhe PORTOKALLIA janë ngjyrat bazë që përdoren për panelet e informatave dhe pajisjet e prodhuara nga materiale retroreflektuese.



E BARDHË

PORTOKALLI

Shtresat fluoreshente të verdha

Kutia e ngjyrës*

Kutia e ngjyrës*

x	y	β
0.305	0.315	min. 0.40
0.335	0.345	
0.325	0.355	
0.295	0.325	

x	y	β
0.595	0.645	min. 0.20
0.645	0.355	max. 0.25
0.570	0.429	
0.531	0.414	

Koeficienti minimal i retroreflektimit

Koeficienti minimal i retroreflektimit

α 20"				
β	5°	30°	40°	
cd/lux/m ²	400	150	30	

α 20"				
β	5°	30°	40°	
cd/lux/m ²	150	90	60	

Këto shtresa sipërfaqësore retroreflektuese duhet të ofrojnë koeficientin minimal të retroreflektimit (RA; njësia cd.lx -1m²) në raport me kërkesat e parapara për secilën ngjyrë, ashtu siç paraqitet më poshtë.



E VERDHË

PORTOKALLI E ERRËT

Kutia e ngjyrës*

Kutia e ngjyrës*

x	y	β
0.47	0.51	min 0.20
0.51	0.47	
0.48	0.44	
0.43	0.48	

x	y	β
0.610	0.390	min. 0.14
0.535	0.375	
0.506	0.404	
0.570	0.429	

Koeficienti minimal i retroreflektimit

Koeficienti minimal i retroreflektimit

α 20"				
β	5°	30°	40°	
cd/lux/m ²	370	64	42	

α 20"				
β	5°	30°	40°	
cd/lux/m ²	65	40	20	

* Në përputhje me CIE 15, duke aplikuar standardin CIE Iluminant D65 dhe kushtet standarde sipas CIE 45/0.

NGJYRAT - RETROREFLEKTUESE

PANELET INFORMATIVE DHE PAJISJET E PRODHUARA NGA MATERIALET RETROREFLEKTUESE

TIPOGRAFIA DHE NGJYRAT

UDHËZIME PËR SINJALIZIMIN E RRUGËS SË SHKOLLËS / KUSHTET PËR PËRGATITJE DHE PRODHIM



E KUQE

Kutia e ngjyrës*

x	y	β
0.735	0.265	min. 0.03
0.700	0.250	
0.610	0.340	
0.660	0.340	

Koeficienti minimal i retroreflektimit

α 20"				
β	5°	30°	40°	
cd/lux/m ²	169	123	12	



E KALTËR E ÇELUR

Kutia e ngjyrës*

x	y	β
0.078	0.171	min. 0.04
0.150	0.220	max. 0.10
0.210	0.160	
0.137	0.038	

Koeficienti minimal i retroreflektimit

α 20"				
β	5°	30°	40°	
cd/lux/m ²	340	135	70	



E KALTËR

Kutia e ngjyrës*

x	y	β
0.195	0.235	min. 0.04
0.225	0.235	max. 0.12
0.225	0.285	
0.195	0.285	

Koeficienti minimal i retroreflektimit

α 20"				
β	5°	30°	40°	
cd/lux/m ²	130	23	9	



E KALTËR E ERRËT

Kutia e ngjyrës*

x	y	β
0.13	0.09	min 0.01
0.16	0.09	max. 0.04
0.16	0.14	
0.13	0.14	

Koeficienti minimal i retroreflektimit

α 20"				
β	5°	30°	40°	
cd/lux/m ²	73	20	9	

*Në përputhje me CIE 15, duke aplikuar standardin CIE Iluminant D65 dhe kushtet standarde sipas CIE 45/0.



E GJELBËR

Kutia e ngjyrës*

x	y	β
0.11	0.415	min. 0.04
0.15	0.415	
0.15	0.455	
0.11	0.455	

Koeficienti minimal i retroreflektimit

α 20"			
β	5°	30°	40°
cd/lux/m ²	114	17	1

KAFE E LEHTË

Kutia e ngjyrës*

x	y	β
0.40	0.460	min 0.05
0.45	0.480	
0.50	0.437	
0.44	0.410	

Koeficienti minimal i retroreflektimit

α 20"			
β	5°	30°	40°
cd/lux/m ²	158	21	1

KAFE E ERRËT

Kutia e ngjyrës*

x	y	β
0.455	0.397	min. 0.04
0.523	0.429	
0.558	0.394	
0.479	0.373	

Koeficienti minimal i retroreflektimit

α 20"			
β	5°	30°	40°
cd/lux/m ²	88	11	1

*Në përputhje me CIE 15, duke aplikuar standardin CIE Iluminant D65 dhe kushtet standarde sipas CIE 45/0.

NGJYRAT - RETROREFLEKTUESE

PANELET INFORMATIVE DHE PAJISJET E PRODHUARA NGA MATERIALET RETROREFLEKTUESE



GRI

Kutia e ngjyrës*

x	y	β
0.305	0.315	min. 0.12
0.335	0.345	max. 0.18
0.325	0.355	
0.295	0.325	

Koeficienti minimal i retroreflektimit

α 20"				
β	5°	30°	40°	
cd/lux/m ²	30	14.4	5.4	

GRI E ERRËT

Kutia e ngjyrës*

x	y	β
0.317	0.320	min. 0.12
0.337	0.345	max. 0.20
0.325	0.355	
0.305	0.330	

Koeficienti minimal i retroreflektimit

α 20"				
β	5°	30°	40°	
cd/lux/m ²	150	50	25	

E ZEZË

Kutia e ngjyrës*

x	y	β


Koeficienti minimal i retroreflektimit

α 20"				
β	5°	30°	40°	
cd/lux/m ²				

*Në përputhje me CIE 15, duke aplikuar standardin CIE Iluminant D65 dhe kushtet standarde sipas CIE 45/0.

NGJYRAT - CMYK

AFISHET, FLAMUJT, PËLHURAT, PANKARTAT, ORARET, SHENJAT "STOP, SHIKO, DËGJO, MENDO", SHENJAT "NDALOHEN TELEFONAT", SHENJAT "BËHU I DUKSHËM" DHE MBISHKRIMET E SHTYPURA NË JELEKET E SIGURISË



E BARDHË

C 0
M 0
Y 0
K 0



E VERDHË

C 0
M 10
Y 100
K 0



PORTOKALLI

C 0
M 30
Y 100
K 0




PORTOKALLI E ERRËT

C 0
M 50
Y 100
K 0



E KUQE

C 0
M 100
Y 100
K 0



E KALTËR E ÇELUR

C 45
M 0
Y 0
K 5



E KALTËR

C 90
M 0
Y 0
K 10



E KALTËR E ERRËT

C 100
M 80
Y 0
K 0

NGJYRAT - CMYK

AFISHET, FLAMUJT, PËLHURAT, PANKARTAT, ORARET, SHENJAT "STOP, SHIKO, DËGJO, MENDO", SHENJAT "NDALOHEN TELEFONAT", SHENJAT "BËHU I DUKSHËM" DHE MBISHKRIMET E SHTYPURA NË JELEKET E SIGURISË



E GJELBËR

C 75
M 0
Y 100
K 0



KAFE E ÇELUR

C 0
M 20
Y 50
K 30



KAFE E ERRËT

C 15
M 35
Y 50
K 70




GRI

C 0
M 0
Y 0
K 40



GRI E ÇELUR

C 0
M 0
Y 0
K 70



GRI E ERRËT

C 0
M 0
Y 0
K 100

PAJISJET
URBANE



PËRVIJUESIT ME NGJYRA

Përvijuesit me ngjyra instalohen afër institucioneve arsimore, përgjatë rrugëve për në shkolla dhe në zonën e qendrave për aktivitete shkollore dhe jashtëshkollore për të theksuar praninë e fëmijëve në rrugë ose përgjatë saj. Distanca ndërmjet përvijuesve përcaktohet duke marrë parasysh elementet gjeometrike të rrugës dhe vetitë specifike të zonës së anës së rrugës. Vëmendje e veçantë u kushtohet zonave të kryqëzimit për t'u siguruar që përvijuesit të mos pengojnë pamjen e kryqëzimeve rrugore.

Nëse përvijuesit nuk mund të pozicionohen (p.sh. trotuari nuk është mjaft i gjerë), atëherë trotuari mund të lyhet me rrrathë me ngjyra.

Si rregull, në zonat e ndërtuara instalohen përvijuesit me ngjyra me diametër 100 mm, ndërsa përvijuesit e sigurisë pasive prej 160 mm (në tekstin e mëparshëm: PSB me ngjyra) pozicionohen jashtë zonave të ndërtuara.


Në zonat e ndërtuara, PBS-të me ngjyrë prej 160 mm mund të instalohen në anën e butë të rrugës ose përdoren për të ndarë fizikisht objektet e këmbësorëve dhe automjetet kur ato nuk janë të ndara nga anësorët.

Nëse përvijuesit me ngjyra janë instaluar në anën e butë të rrugës në të cilën ecin fëmijët, sipas Rregullave të Qarkullimit Rrugor (ZPrCP), përveç devijimeve përkatëse, toka duhet të ngjeshet dhe shiriti duhet të jetë i gjerë mjaftueshëm.

Në zonat e kalimit të këmbësorëve, mund të instalohen edhe përvijuesit me ngjyrë prej 100 mm me fusha të bardha dhe blu ose PBS me ngjyrë blu prej 160 mm. Këto lloj përvijuesish vendosen menjëherë para dhe pas kalimit në të dy anët e rrugës.

Në raste të jashtëzakonshme, përvijuesit prej 100 mm mund të zëvendësohen me përvijues prej 64 mm.

Përfundimisht bëjnë kolonat mbajtëse apo pajisjet e tjera urbane që mund të kenë gjithashtu të njëjtin model ngjyrash si përvijuesit me ngjyra.




SINJALIZIMI I ZONAVE SHKOLLORE

Sinjalistikat rrethore të montuara në kolona me ngjyra janë me ngjyrë portokalli. Sinjalizimi i zonave shkollore aplikohet ekskluzivisht në zonën e shkollave (si rregull, në zonën e shpejtësisë maksimale, zonat e trafikut të përbashkët dhe zonat e trafikut të ngadaltë), aty ku zbatohen masa për qetësim të trafikut, ose kur shpejtësia maksimale e autorizuar jashtë zonave të banuara reduktohet në të paktën 50 km/h.

Në zonat ku ka shkolla muzike, shfaqen shenjat e SHKOLLËS MUZIKORE.

Skaji i poshtëm i kolonës me ngjyra vendoset 0.3 m mbi nivelin e sipërfaqes së përfunduar të trotuarit ose mbi nivelin e sipërfaqes së përfunduar të rrugës, nëse rruga nuk ka trotuar.




ETIKETAT NGJITËSE PËR SINJALIZIMIN E RRUGËS

Etiketat ngjitëse janë me ngjyrë të verdhë.
Ato ngjiten në trotuar pranë institucioneve arsimore
dhe në rrugët e shkollave.

Etiketat ngjitëse për sinjalizimin e rrugëve duhet
të plotësojnë kriteret për përdorim në ambientet e
jashtme. Ato duhet të jenë rezistente ndaj rrëshqitjes
(SRT) në masë të mjaftueshme.



Dizajni i etiketës ngjitëse



Struktura e etiketës ngjitëse

SINJALISTIKAT “FËMIJË NË RRUGË”


Këto shenja janë të verdha.

Ato montohen në zonat e kalimit të këmbësorëve, pranë shkollave, në kryqëzime, ku në bazë të Ligjit për Rrugët, vendosja e shenjave të përcaktuara të qarkullimit rrugor për të sinjalizuar kalimin e këmbësorëve nuk është i detyrueshëm.

Ato montohen gjithashtu në zonat ku fëmijët ecin në këmbë për në shkollë.



Dizajni i sinjalistikës



Struktura e sinjalistikës

SINJALISTIKAT E ÇIKLISTËVE


Këto shenja janë të verdha.

Ato montohen në zonat e kalimit të biçikletave, në kryqëzime, pranë shkollave, ku në bazë të Ligjit për Rrugët, vendosja e shenjave të përcaktuara të qarkullimit për të sinjalizuar kalimin e çiklistëve nuk është i detyrueshëm.

Ato montohen gjithashtu në zonat ku fëmijët shkojnë me biçikletë për në shkollë.



Dizajni i sinjalistikës




Struktura e sinjalistikës


SINJALISTIKAT E KËNDIT TË LOJRAVE

Këto shenja janë të verdha.

Ato montohen në zonat e këndeve të lojërave ku fëmijët rrinë shpesh ose luajnë, dhe në rrugë ku fëmijët mblihen dhe luajnë për shkak të karakteristikave urbane të hapësirës.



Dizajni i shenjës



Struktura e shenjës

SINJALISTIKAT E SHKALLËVE


Këto shenja janë të verdha.

Këto shenja mund të tregojnë shkallë që ndodhen nga ana e majtë ose e djathtë.

Montohen në zonat e shkallëve, nga ku fëmijët mund të dalin papritmas në rrugë (institucione arsimore ose rrugës për në shkollë).



Dizajni i shenjës 1



Dizajni i shenjës 2 dhe struktura e shenjës


SINJALISTIKAT E KONTROLLORIT TË TRAFIKUT

Këto shenja janë të verdha.

Ato vendosen në rrugë, përpara mbërritjes tek vendi ku siguria e fëmijëve në trafikun rrugor ofrohet në përputhje me Rregullat e Qarkullimit Rrugor (ZPrCP).



Dizajni i shenjës 1



Dizajni i shenjës 2 dhe struktura e shenjës

SINJALISTIKAT “FËMIJË ME TULLUMBACE”


Këto shenja janë me ngjyrë portokalli.

Ato instalohen në rrugët drejt shkollave dhe pranë shkollave, si dhe qendrave për aktivitete shkollore dhe jashtëskollore, për të paralajmëruar drejtuesit e automjeteve rreth pranisë së fëmijëve në trafikun rrugor.


Kufizimi i shpejtësisë në rrugë (V85) mund të shfaqet në tullumbace, me kusht që t'u përgjigjet elementeve gjeometrike të rrugës dhe kushteve të sigurisë në trafik (besueshmëria).

Kur tabelat vendosen pranë shkollave dhe qendrave për aktivitete shkollore dhe jashtëskollore, ato duhet të jenë të dukshme vetëm kur në qendër ka fëmijë dhe në bazë të aktiviteteve të tyre janë të pranishëm në trafikun rrugor. Kur fëmijët nuk janë të pranishëm, tabelat duhet të mbulohen, të hiqen ose të palosen (në rastin e tabelave të palosshme).

Skaji i poshtëm i tabelës vendoset në një lartësi prej 1.2 m mbi nivelin e sipërfaqes së përfunduar të rrugës.



Dizajni i shenjës 1



Dizajni i shenjës 2 dhe struktura e shenjës

SINJALISTIKAT PËR ECJE NË MAL DHE PËR SKIATORË

Këto shenja janë me ngjyrë portokalli.

Ato instalohen në zonën e qendrave të aktiviteteve shkollore dhe jashtëshkollore, etj.

Tabelat duhet të jenë të dukshme vetëm kur në qendër ka fëmijë dhe në bazë të aktiviteteve të tyre janë të pranishëm në trafikun rrugor.

Kur fëmijët nuk janë të pranishëm, tabelat duhet të mbulohen, të hiqen ose të palosen (në rastin e tabelave të palosshme).


Në varësi të nevojave, mund të përdoret ekrani LED me simbolet "fëmijë" ose "çiklist". Në rastet ku nuk ka shenja trafiku për kufizimin e shpejtësisë në zonë, kufiri i shpejtësisë nuk shfaqet në ekranin LED.

Aty ku nuk ka kufizim shpejtësie, kur afrohet një automjet, mund të aktivizohen dy sinjale pulsuese për të theksuar rëndësinë e përmbajtjes së shfaqur në ekranin LED.

Struktura mbështetëse e ekraneve LED jashtë zonave të ndërtuara duhet të jetë pasivisht e sigurt dhe në përputhje me kërkesat e SIST EN 12767:2019 (Siguria pasive e strukturave mbështetëse për pajisjet rrugore - Kërkesat dhe metodat e testimit).



Dizajni i shenjës 1



Dizajni i shenjës 2 dhe struktura e shenjës

SINJALISTIKAT E ZONËS PËR LËNIEN DHE MARRJEN E FËMIJËVE

Këto shenja janë të verdha.

Ato montohen në vendet ku ekzistojnë vendkalime këmbësorësh për në shkollë. Kjo bëhet me qëllim që të nxitet ecja në këmbë për në shkollë dhe zvogëlimi i trafikut të automjeteve në zonat shkollore.

Gjatë sinjalizimit të zonës që shërben për lënie dhe marrje të fëmijëve, merren parasysh rregullat për ndalimin e sigurt dhe parkimin e automjetit, në përputhje me Aktin e Rregullave të Trafikut Rrugor për t'u mundësuar fëmijëve të dalin/hyjnë në automjet në mënyrë të sigurt.

Shenjat e Zonës për ndalim të shkurtër të automjeteve (Përshëndet dhe Largohu) montohen brenda një rrezeje prej rreth 300 m në zonat shkollore. Zona të tilla përcaktohen me ndihmën e ekspertëve të sigurisë së trafikut rrugor. Shkollat mund të promovojnë të ecurit në këmbë duke mbledhur pikë (garë ndërmjet nxënësve që ecin në këmbë). Në fund të vitit shkollor, nxënësi që mbledh më shumë pikë merr shpërblim.



Dizajni i shenjës 1



Dizajni i shenjës 2




Dizajni i shenjës 3 dhe struktura e shenjës


SINJALISTIKAT E STACIONIT TË AUTOBUSIT TË SHKOLLËS

Këto shenja janë të verdha.

Ato instalohen ekskluzivisht në stacionet e autobusëve të shkollës. Si rregull, ato instalohen në vendet ku, në përputhje me Rregullat për shenjat dhe pajisjet e trafikut në rrugë dhe Rregullat për stacionet e autobusëve, kushtet për sinjalizimin e stacionit të autobusit nuk plotësohen dhe autobusi shkollor bën ndalesa në përputhje me Ligjin për Rregullat e Qarkullimit Rrugor (ZPrCP).




Dizajni i shenjës




Struktura e shenjës

SISTEMI AKTIV PËR SINJALIZIM TË STACIONIT TË AUTOBUSIT SHKOLLOR

Qëllimi i sistemit është të paralajmërojë në mënyrë aktive drejtuesit e mjeteve lidhur me praninë e fëmijëve të shkollës në zonën e pritjes. Sistemi (dritat pulsuese) duhet të funksionojë vetëm kur fëmijët e shkollës janë në zonën e pritjes.



Dizajni i shenjës




Struktura e shenjës



ORARET

Këto shenja të rrumbullakëta janë të verdha dhe baza është e zezë.

Këto shenja përdoren për të treguar orarin e autobusit shkollor dhe instalohen në stacionet e autobusëve të shkollës.



Dizajni i shenjës



Struktura e shenjës

SINJALISTIKAT “SHPEJTËSIA JUAJ”

Këto shenja janë të verdha. Ato duhet të bëhen në madhësi proporcionale, në varësi të dimensionit të ekranit LED të instaluar.

Ata montohen në vende ku shpesh mbliidhen fëmijët (në afërsi të institucioneve arsimore ose përgjatë rrugëve për në shkollë) dhe ku drejtuesve duhet t'u rikujtohet kufiri i shpejtësisë.

EKRANI DUHET FUNKSIONOJË SI NË VIJIM:

Si rregull, shpejtësia nuk shfaqet si sinjal pulsues (vetëm paraqitje statike).

Nëse shfaqen ikonat ☺ ose ☹, ato mund të ndryshojnë në mënyrë alternuese me shfaqjen e shpejtësisë (por jo si sinjal pulsues).

Koha minimale e shfaqjes së përmbajtjes së caktuar (paraqitja e shpejtësisë dhe fytyrës së lumtur ☺ ose të trishtuar ☹) është 1 deri në 3 sekonda.

Mënyra dhe koha e shfaqjes alternative varen nga vendndodhja e ekranit, shpejtësia e automjetit dhe koha përkatëse e perceptimit, si dhe nga elementet e rrugës dhe anës së rrugës.

- Paraqitja e shpejtësisë është portokalli.
- Shpejtësia e tepërt mund të paraqitet gjithashtu me të kuqe.
- Ikona ☺ ose ☹ paraqitet me të njëjtën ngjyrë si shpejtësia.

- Lartësia e numrave dhe ikonave (☺ ose ☹) në ekran varen nga shpejtësia e automjetit.
- Për shpejtësi deri në 40 km/h, lartësia është ndërmjet 220 dhe 270 mm.
- Për shpejtësi prej 40 km/h deri në 50 km/h, lartësia është ndërmjet 270 dhe 300 mm.
- Për shpejtësi prej 50 km/h deri në 70 km/h, lartësia është ndërmjet 300 dhe 340 mm.
- Shpejtësia që tejkalon kufirin për më shumë se 20 km/h nuk shfaqet - vetëm fytyra e pikëlluar ☹ mund të shfaqet.
- Ekranet duhet të kenë një sensor të integruar të dritës për të rregulluar ndriçimin e ditës/natës.

Në vend të shenjes, mund të përdoret edhe silueta e një fëmije.



Dizajni i shenjes 1



Dizajni i shenjes 2



Silueta e fëmijës me SHENJËN “SHPEJTËSIA JUAJ”

EKRANET LED PËR FËMIJË

Këto ekrane LED përdoren afër institucioneve arsimore dhe përgjatë rrugëve për në shkolla.


Si rregull, ato instalohen kur drejtuesit duhet të paralajmërohen veçanërisht për praninë e fëmijëve në trafikun rrugor dhe për kufirin e shpejtësisë (paraqitja e shpejtësisë maksimale duhet të tregojë kufirin aktual të përcaktuar me shenjën e trafikut).

Ngjyra bazë e bardhë e diodës LED për të shfaqur simbolin e fëmijës mund të zëvendësohet me një diodë të verdhë LED nëse parashikohet që shenja aktive të jetë brenda zonës së pajisjeve të mbetura urbane në përputhje me këto udhëzime.


SHEMBUJ TË OPSIONEVE TË EKRANËVE:

- Kur shpejtësia e automjetit është nën ose e barabartë me kufirin e shpejtësisë, shfaqet simboli i fëmijës.
- Kur shpejtësia e automjetit tejkalohet, simboli i fëmijës dhe kufiri i shpejtësisë shfaqen në mënyrë alternative (njëri pas tjetrit). Në versionin e sinjalit pulsues, kufiri i shpejtësisë shfaqet në mënyrë të përhershme. Për të theksuar rëndësinë e shenjës së trafikut, aktivizohen dy sinjale pulsuese.
- Në versionin e sinjalit pulsues, mund të instalohen sensorë shtesë për zbulimin e këmbësorëve. Në këtë rast, kur sensori zbulon praninë e një këmbësori në trafikun rrugor aktivizohen dy sinjale pulsuese.
- Një ekran (me sensor për zbulim të këmbësorëve) mund të përdoret gjithashtu ku fëmijët ecin për në shkollë ose nga shkolla përgjatë ndonjë korsie ose rruge për këmbësorë.

OPSIONI PA SINJALIN PULSUES



OPSIONI ME SINJALIN PULSUES



EKRANET LED PËR ÇIKLISTË

Këto ekrane LED përdoren afër institucioneve arsimore dhe përgjatë rrugëve për në shkolla.


Si rregull, ato instalohen kur drejtuesit duhet të paralajmërohen veçanërisht për praninë e fëmijëve në trafikun rrugor dhe për kufirin e shpejtësisë (paraqitja e shpejtësisë maksimale duhet të tregojë kufirin aktual të përcaktuar me shenjën e trafikut).

Ngjyra bazë e bardhë e diodës LED për të shfaqur simbolin e çiklistit mund të zëvendësohet me një diodë të verdhë LED nëse parashikohet që shenja aktive të jetë brenda zonës së pajisjeve të mbetura urbane në përputhje me këto udhëzime.


SHEMBUJ TË OPSIONEVE TË EKRANËVE:

- Kur shpejtësia e automjetit është nën ose e barabartë me kufirin e shpejtësisë, shfaqet simboli i çiklistit.
- Kur shpejtësia e automjetit tejkalohet, simboli i çiklistit dhe kufiri i shpejtësisë shfaqen në mënyrë alternative (njëri pas tjetrit). Në opsionin me sinjal pulsues, kufiri i shpejtësisë shfaqet në mënyrë të përhershme. Për të theksuar rëndësinë e shenjës së trafikut, aktivizohen dy sinjale pulsuese.
- Në opsionin e sinjalit pulsues, mund të instalohen sensorë shtesë për zbulimin e këmbësorëve. Në këtë rast, kur sensori zbulon praninë e një këmbësori në trafikun rrugor aktivizohen dy sinjale pulsuese.
- Një ekran (me sensor për zbulim të çiklistëve) mund të përdoret gjithashtu ku fëmijët lëvizin me biçikletë për në shkollë ose nga shkolla përgjatë rrugës apo korsisë së biçikletave

OPSIONI PA SINJALIN PULSUES



OPSIONI ME SINJALIN PULSUES



KËRKESAT TEKNIKE PËR EKTRANET LED (PËR FËMIJË DHE ÇIKLISTË)

Përshkrimi i produktit

Sinjalet e mesazheve të ndryshueshme (VMS) duhet të përbëhen nga dioda për emetim të dritës me fuqi të lartë (LED) që lëshojnë ngjyrë të kuqe, të bardhë dhe/ose dritë të verdhë dhe të kaltër. Shenjat duhet të jenë qartazi të dukshme në të gjitha kushtet atmosferike.

Sinjalet aktive duhet të jetë në përputhje me EN 12899-1 ose EN 12899- 2 – Sinjalet fikse vertikale të trafikut rrugor; Përvijuesi i transiluminuar i trafikut (TTB).

Struktura e shenjave transndriçuese (të transiluminuara) të komunikacionit rrugor duhet të plotësojë kërkesat vijuese të rezistencës minimale mekanike në përputhje me Rregullat për shenjat dhe pajisjet e trafikut rrugor.

Karakteristikat:

- Duhet të sigurohet ndriçim i qëndrueshëm pavarësisht nga luhatjet e mundshme në furnizimin me energji elektrike;
- Pajisja duhet të jetë rezistente ndaj pranisë së vazhdueshme të substancave përcuese që formohen nga pluhuri, shiu ose bora;
- Duhet të ketë mundësi të rregullimit automatik të ndriçimit optimal sipas kushteve të mjedisit në të cilin ndodhet ekrani, ku ndriçimi kontrollon nga moduli i gjerësisë së pulsit.
- Duhet të përdoren dioda LED, rezistente ndaj UV-së me intensitet të lartë;
- Diodat LED duhet të mbrohen nga dëmtimet mekanike përmes lenteve të qëndrueshme UV;
- Zëvendësimi i komponentëve të integruar duhet të jetë i lehtë;
- Duhet të mundësojë shfaqjen e përmbajtjes në mënyrë të vazhdueshme ose pulsuese, me mundësi të rregullimit të shpejtësisë së pulsimit;
- Dy sinjale pulsuese (ashtu siç janë zgjedhur);
- Duhet të ketë detektor mikrovalë të integruar;
- Duhet të ketë detektim të rregullueshëm të shpejtësisë së automjetit;
- Duhet të sigurohet funksionimi i pavarur në rast të dështimit të komunikimit me qendrën e kontrollit;
- Shenjat LED-VMS duhet të plotësojnë ose të tejkalojnë kriteret për shenjat e mesazheve të ndryshueshme të përcaktuara me EN 12966-1:2005 standardi A1:2009;
- Shenjat duhet të prodhohen dhe testohen në përputhje me standardin ISO 9001:2015, 14001:2015.

Tabela dhe simbolet (piktogramet) e përmbajtjes:

Përmbajtja	Madhësia	Ngjyra
Kufizimi i shpejtësisë	45 cm	rrethi - i kuq, simboli - i bardhë
Fëmijët	45 cm	e bardhë ose e verdhë, e kaltër, e kuqe
Sinjalistikat pulsuese të rrugës (opsion)	8 cm	e verdhë

Diodat LED me ngjyra	Klasifikimi sipas standardit EN 12966-1:2005 A1:2019			
	Ndriçimi	Ngjyra	Gjerësia e rrezes së dritës	Kontrasti
E bardhë	L3	C2	B4	R2
E verdhë	L3	C2	B4	R2
E kaltër	L3	C2	B4	R2
E kuqe	L3	C2	B4	R2


NJOFTIMET PËR
PËRMIRËSIMIN E
SIGURISË RRUGORE



PËLHURAT

Pëlhurat janë të verdha.

Pëlhurat janë projektuar për t'u montuar në rrethojat e shesheve të lojërave, në zonat e shkollave dhe në këndet e lojërave për fëmijë.



PANKARTAT

Pankartat janë të verdha.

Qëllimi i tyre është të informojnë dhe të paralajmërojnë drejtuesit e mjeteve lidhur me fillimin e vitit shkollor, dhe parimisht, janë të përkohshme.

Ato montohen në vende ku strukturat mbështetëse tashmë ekzistojnë.

Teksti dhe madhësia mund të ndryshohen sipas nevojës.

DREJTO ME KUJDES! = DRIVE CAREFULLY!
RRUGË SHKOLLE - SCHOOL ROUTE



DREJTO ME KUJDES!



RRUGË SHKOLLE




Dy shembuj të dizajnit të pankartave

FLAMUJT

Flamujt janë të verdhë dhe përdoren për të treguar rrugët dhe zonat shkollore në fillim të vitit shkollor.

Qëllimi kryesor i tyre është informimi dhe paralajmërimi i drejtuesve të mjeteve lidhur me fillimin e vitit shkollor. Në parim, ata janë të përkohshëm.



Tre shembuj të dizajnit të flamurit

AFISHET

Afishet janë të verdha.

Qëllimi i tyre është të informojnë dhe të paralajmërojnë drejtuesit e mjeteve lidhur me fillimin e vitit shkollor, dhe parimisht, janë të përkohshme.

Teksti mund të ndryshohet sipas nevojës.

RRUGË SHKOLLE = SCHOOL ROUTE
DREJTO ME KUJDES! = DRIVE CAREFULLY!
#sërishnëshkollë = #BackToSchool




Tre shembuj të dizajnit të afisheve

SINJALISTIKAT E TESTIMIT TË AFTËSISË SË ÇIKLIMIT

Këto shenja janë të verdha.

Ato instalohen për të orientuar fëmijët teksa kryejnë teste të dhënies së biçikletës në përputhje me Aktin e Drejtuesve (ZVoz-1) dhe Aktin e Rregullave të Qarkullimit Rrugor (ZPrCP) dhe për të paralajmëruar drejtuesit e mjeteve lidhur me praninë e çiklistëve në trafikun rrugor.


Ato nuk zëvendësojnë praninë e përfaqësuesve të Këshillit të Sigurisë Rrugore dhe/ose Policisë.



Dizajni i shenjës 1

Dizajni i shenjës 2 dhe struktura e shenjës


SINJALISTIKAT E TESTIMIT TË AFTËSISË SË ÇIKLIMIT




Dizajni i shenjës 3



Dizajni i shenjës 4



Dizajni i shenjës 5



Dizajni i shenjës 6 dhe struktura e shenjës

ETIKETAT NGJITËSE ME SHENJËN E AUTOBUSIT

Këto etiketa ngjitëse janë në formë katrore.

Madhësia e tyre është 400 × 400 mm. Këto etiketa janë të verdha.

Në raste të jashtëzakonshme, mund të përdoren gjithashtu edhe etiketa ngjitëse 250 × 250 mm me një cep të gjerë 6 mm.

Etiketat mund të dizajnohen si etiketa magnetike ose si pllaka të palosshme dhe janë të dukshme vetëm kur automjeti transporton ndonjë grup fëmijësh.


Këto etiketa ngjitëse vendosen në anën e djathtë të automjetit dhe nuk zëvendësojnë shenjë të automjetit që transporton grupin e fëmijëve.

Ato synojnë të rrisin vetëdijen e drejtuesve të mjeteve lidhur me dispozitat e Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor (ZPrCP).

LIGJI KUFIZON PËR TË MBROJTUR = LEGAL ACTION FOR PROTECTION!
AUTOBUS SHKOLLE = SCHOOL BUS



Dizajni i shenjës 1



Dizajni i shenjës 2 dhe struktura e shenjës

4 x P

Këto shenja janë të verdha.

Ato instalohen në rrugët e shkollave, sidomos në zonat e kalimit të këmbësorëve.

Ato synojnë të rrisin vetëdijen dhe të paralajmërojnë fëmijët që të mos përdorin telefonat celularë pranë trafikut. Për këtë qëllim, ato vendosen ose drejtohen në mënyrë që të mos jenë të dukshme për drejtuesit nga rruga.

NDALO, SHIKO, DËGJO, MENDO! = STOP, LOOK, LISTEN, THINK!



Dizajni i shenjës 1



Dizajni i shenjës 2 dhe struktura e shenjës

NDALOHEN TELEFONAT CELULARË

Këto shenja janë të verdha.

Ato instalohen në rrugët e shkollave dhe në zonat shkollore.

Ato synojnë të rrisin vetëdijen dhe të paralajmërojnë fëmijët që të mos përdorin telefonat celularë pranë trafikut. Për këtë qëllim, ato pozicionohen ose drejtohen në mënyrë që të mos jenë të dukshme për drejtuesit nga rruga.

Shiko përpara! #NdalohenTelefonatCELULARË = Look Forward!
#NoMobilePhones



Dizajni i shenjës



Struktura e shenjës

SINJALISTIKAT “BËHU I DUKSHËM”

Këto shenja janë me ngjyrë blu të errët.


Ato instalohen në rrugët drejt shkollave dhe në zonat shkollore.

Ato synojnë të rrisin vetëdijen dhe të paralajmërojnë fëmijët lidhur me përdorimin e saktë të veshjeve dhe aksesorëve reflektues. Për këtë qëllim, vendosen ose drejtohen në mënyrë që të mos jenë të dukshme për drejtuesit nga rruga.

#BëhuiDukshëm #BëhuiKujdesshëm = #BeVisible #BeCareful



Dizajni i shenjës



Struktura e shenjës

BËHU PËRDORUES I VËMENDSHËM I RRUGËS

Këto shenja janë të verdha.

Ato instalohen në rrugët e shkollave, ku fëmijët ecin drejt shkollës përgjatë rrugës ose në tokë të butë të bankinave të rrugëve, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Rregullat e Qarkullimit Rrugor.

Qëllimi i tyre është të paralajmërojnë drejtuesit e mjeteve lidhur me praninë e fëmijëve në rrugë ose anëve të rrugës dhe të rrisin vetëdijen lidhur me sjelljen e kujdesshme në trafik.

Si rregull, shenjat vendosen jashtë zonave të ndërtuara.

#BeAConsiderateRoadUser = #BëhuPërdoruesiVëmendshëmiRrugës



Dizajni i shenjës



Struktura e shenjës

BËHU PËRDORUES I RESPEKTUESHËM I RRUGËS

Këto shenja janë të verdha.

Ato instalohen në rrugët e shkollave, pranë zonave të kalimit të këmbësorëve, ku fëmijët shpesh kalojnë rrugën, teksa lëvizin për në shkollë dhe kthehen nga shkolla.

Qëllimi i tyre është të paralajmërojnë drejtuesit e mjeteve në afërsi të kalimit të këmbësorëve dhe pranisë së fëmijëve në rrugë dhe të rrisin vetëdijen lidhur me sjelljen e respektueshme në trafik.

Si rregull, shenjat vendosen jashtë zonave të ndërtuara.

#BeRespectfulRoadUser = #BëhuPërdoruesiRespektueshëmiRrugës



Dizajni i shenjës



Struktura e shenjës

BËHU PËRDORUES TOLERANT I RRUGËS

Këto shenja janë të verdha.

Ato instalohen në zonat e stacioneve të autobusëve (të shkollës), rrugëve ku ndalojnë automjetet që transportojnë fëmijë dhe sinjalizohen me një shenjë që tregon se mjete transporton një grup fëmijësh.

#BeATolerantRoadUser = #BëhuPërdoruesTolerantiRrugës

Qëllimi i tyre është të paralajmërojnë drejtuesit e mjeteve lidhur me respektimin e dispozitave të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor (ZPrCP) dhe pranisë së fëmijëve në rrugë ose afër rrugës dhe të rrisin vetëdijen lidhur me sjelljen tolerante në trafik.

Si rregull, shenjat vendosen jashtë zonave të ndërtuara.



Dizajni i shenjës



Struktura e shenjës

JELEKËT E SIGURISË PËR FËMIJË

Mund të përdoret gjithashtu edhe një simbol i printuar në jelekët e sigurisë për fëmijë.

Jelekët e sigurisë duhet të jenë në përputhje me standardin ISO 20471:2013/Amd 1:2016 (Veshje me dukshmëri të lartë – Metodat dhe kushtet e provës)



Shembull i dizajnit të jelekut

SINJALISTIKAT E SILUETËS

Shenjat e siluetave përdoren për të shënuar rrugët drejt shkollave dhe zonat shkollore.

Qëllimi kryesor i tyre është të njoftojnë dhe të paralajmërojnë drejtuesit e mjeteve lidhur me praninë e fëmijëve në trafikun rrugor. Ato mund të vendosen në bazamente të lëvizshme dhe në shtyllat e ndriçimit të rrugëve. Ato mund të përdoren në zonat shkollore për të parandaluar parkimin dhe ndalimin anës rrugëve ose në trotuar.



Dizajni i shenjës 1



Dizajni i shenjës 2 dhe struktura e shenjës

SINJALISTIKAT “SHIKO”

Sinjalistikat horizontale janë të bardha, pa veti reflektuese dhe kanë rezistencë të përshtatshme rrëshqitëse (SRT).

Si rregull, vendosen pranë trotuarit (përpara kalimit të këmbësorëve).

Mbishkrimi duhet të ketë skaje të mprehta dhe shkronjat duhet të jenë të vazhdueshme.

Look = Shiko



Dizajni i mbishkrimit




Struktura e mbishkrimit

Në rrugët me një drejtim ose rrugët ku dy korsi janë fizikisht të ndara nga një ishull në mes me një sipërfaqe pritjeje, përdoret mbishkrimi vetëm me një shigjetë (të përshtatur sipas drejtimit).



PROJEKTIMI I ZONAVE
TË TRAFIKUT




PROJEKTIMI I ZONAVE TË TRAFIKUT NË ZONAT SHKOLLORE

SHEMBULL I NJË RRUGE JASHTË NJË ZONE TË NDËRTUAR

Pamja më poshtë tregon konceptin e një mase për qetësim të trafikut në kombinim me sinjalistikën horizontale të trafikut dhe pajisjet urbane.

Shenjat “FËMIJË NË RRUGË” janë me përmasa 900 x 900 mm. Gjerësia e njoftimit “SHPEJTËSIA JUAJ” duhet të përshtatet me shenjë.

Planifikimi urban dhe dizajni arkitekturor duhet të jetë në harmoni me regjimin e qarkullimit rrugor në mënyrë profesionale dhe të mirë menduar, dhe përveç faktorëve njerëzorë në trafik (psikologjia e trafikut), duhet të marrin parasysh gjithashtu funksionin e rrugës (numrin dhe strukturën e automjeteve) dhe gjendjen e pjesëve anësore të rrugës.



PSB = passive safe bollard

PROJEKTIMI I ZONAVE TË TRAFIKUT NË ZONAT SHKOLLORE

SHEMBUJ TË RRUGËVE NË ZONAT E NDËRTUARA



Konceptet e sinjalistikave horizontale për zonat e trafikut pranë institucioneve arsimore ose zonave për qetësim të trafikut, zonave të trafikut të përbashkët dhe zonave të trafikut të ngadaltë janë dhënë më poshtë.

Fillimi i zonës shkollore duhet të sinjalizohet edhe me pajisje urbane.



Sinjalizimi i zonës së përbashkët me kufizim të shpejtësisë prej 20 km/h mund të aplikohet edhe duke theksuar vizualisht kufirin e shpejtësisë 20 (km/h) ose kufirin e shpejtësisë 10 (km/h) në zonat me trafik të ngadaltë. Për zonat e kopshteve, shenja "KOPSHT FËMIJËSH" mund të përdoret në të njëjtën mënyrë si shenja "SHKOLLË".

Detajet (dizajni) duhet të përshtaten me funksionin e rrugës, specifikave të zonës buzë rrugës dhe nevojave reale.

Shembulli 1




Shembulli 2




PROJEKTIMI I ZONAVE TË TRAFIKUT NË ZONAT SHKOLLORE

Shembulli 3





Shembulli 4



PROJEKTIMI I ZONAVE TË TRAFIKUT NË ZONAT SHKOLLORE

SHEMBUJ RRUGËSH NË ZONA TË NDËRTUARA ME NDALESA PËR AUTOBUSË NË RRUGË ME DY KORSI




PROJEKTIMI I ZONAVE TË TRAFIKUT NË ZONAT SHKOLLORE


SHEMBUJ RRUGËSH NË ZONAT E NDËRTUARA PRANË KRYQËZIMEVE

Pamja në vijim tregon konceptin e një mase për qetësim të trafikut në kombinim me sinjalistikën horizontale të qarkullimit dhe pajisjet urbane.

Gjatë projektimit dhe zbatimit, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet rregullimit të përvijuesëve në zonat e kryqëzimit për t'u kujdesur që ato të mos pengojnë dukshmërinë.



PROJEKTIMI I ZONAVE TË TRAFIKUT NË ZONAT SHKOLLORE



SHEMBUJ TË RRUGËVE
NË ZONAT E QETËSIMIT TË
TRAFIKUT APO NË ZONAT E
TRAFIKUT TË PËRBASHKËT


Pamja jep konceptin për kombinimin e
trafikut dhe planifikimit urban, si dhe
dizajnit arkitekturor në zona shkollore
ku sinjalet e trafikut kufizojnë shpejtësinë
maksimale të automjetit në 30 km/h.

FORMAT, PËRMASAT DHE PËRCAKTIMI I GRAFIKUT TE NGJYRAVE RAL PËR TË APLIKUAR VIJËZIMET (DETAJET) NË KARREXHATË

SIMBOLET E TROTUARIT


Ngjyra:

- E kaltër RAL 5015
- E kuqe RAL 3020



Ngjyra:


- E verdhë RAL 1023



CARRIAGEWAY SYMBOLS


Ngjyra:

- E verdhë RAL 1023
- E kaltër RAL 5015
- E kuqe RAL 3020




Ngjyra:

- E verdhë RAL 1023
- E kaltër RAL 5015
- E kuqe RAL 3020




Ngjyra:

- E verdhë RAL 1023
- E kaltër RAL 5015
- E kuqe RAL 3020



Ngjyra:


- E verdhë RAL 1023
- E kaltër RAL 5015
- E kuqe RAL 3020



SIMBOLET E RRUGËS ME DY KORSI


Ngjyra:

- E verdhë RAL 1023
- E kaltër RAL 5015
- E kuqe RAL 3020




Ngjyra:

- E verdhë RAL 1023
- E kaltër RAL 5015
- E kuqe RAL 3020




Ngjyra:

- E verdhë RAL 1023
- E kaltër RAL 5015
- E kuqe RAL 3020



Ngjyra:


- E verdhë RAL 1023
- E kaltër RAL 5015
- E kuqe RAL 3020



Simbolet e rrugës me dy korsit duhet të kenë skaje të mprehta dhe simbolet individuale duhet të kenë vija të vazhdueshme (ashtu siç tregohet në detaje).


FORMAT, PËRMASAT DHE PËRCAKTIMI I GRAFIKUT TË NGJYRAVE RAL PËR TË APLIKUAR VIJËZIMET (DETAJET) NË KARREXHATË

VIJËZIMI I ZONËS SË VERDHË ME THEKSIM VIZUAL TË KUFIRIT TË SHPEJTËSISË 10 (KM/H), që tregohet nga një shenjë e qarkullimit rrugor që përdoret për qetësim të trafikut.



■ E verdhë RAL 1023


SHENJA E ZONËS SË SHKOLLËS ËSHTË E ZEZË ME BAZË TË VERDHË ME THEKSIM TË KUFIZIMIT TË SHPEJTËSISË 30 (km/h)*, që tregohet nga shenja rrugore.



■ E verdhë RAL 1023

■ E zezë

SHENJA E ZONËS SË SHKOLLËS ËSHTË E VERDHË ME THEKSIM VIZUAL TË KUFIRIT TË SHPEJTËSISË 30 (km/h), që tregohet nga shenja rrugore.




■ E verdhë RAL 1023

* Shenja e zonës së shkollës "SHKOLLA" është e zezë mbi bazë të verdhë me theksim vizual të kufirit të shpejtësisë prej 30 (km/h).

Theksimi vizual i kufirit të shpejtësisë (10, 20 ose 30 km/h) bëhet duke marrë parasysh kufirin aktual të shpejtësisë të përcaktuar nga shenja rrugore.

FORMAT, PËRMASAT DHE PËRCAKTIMI I GRAFIKUT TË NGJYRAVE RAL PËR TË APLIKUAR SHENJAT (DETAJET) NË RRUGË ME DY KORSI



SINJALIZIMI I ZONËS SË SHKOLLËS ËSHTË I ZI MBI BAZË TË VERDHË ME ngushtim (shembull për një rrugë me gjerësi 6.5 m).

Si rregull, shenja përdoret në rrugët ku elementet gjeometrike (kryesisht gjerësia) dhe shtrirja nuk do të lejonin që treguesi l=1.6 m të jetë i dukshëm në kohë ose i perceptueshëm siç duhet, dhe rrjedhimisht, edhe i zbulueshëm.


Kur nuk ka nevojë të ngushtohet optikisht rruga me dy korsi, treguesi në një bazë të verdhë mund të përdoret edhe pa shenja të verdha për ngushtim rruge.

Ngjyra

■ E verdhë RAL 1023

■ E zezë

FORMAT, PËRMASAT DHE PËRCAKTIMI I GRAFIKUT TË NGJYRAVE RAL PËR TË APLIKUAR SHENJAT (DETAJET) NË RRUGË ME DY KORSI



Ngjyra

- E verdhë RAL 1023
- E kaltër RAL 5015
- E kuqe RAL 3020

SHENJAT "FRESKORJA E NGJYRAVE" PËR TË PARALAJMËRUAR DREJTUESIT PËR RRUGË TË NGUSHTA ME FUSHËPAMJE TË DOBËT NË ZONAT SHKOLLORE

Shenjat përdoren gjithmonë vetëm në korsinë kryesore të trafikut, në afërsi të drejtpërdrejtë të shtigjeve të ngushta ose rrugëve dytësore.

MË TË SIGURT PËR NË SHKOLLË

Udhëzime për instalimin e pajisjeve urbane dhe projektimin arkitekturor të zonave të trafikut për përmirësimin e sigurisë rrugore për fëmijët e shkollës

Publikuar nga

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
Agjencia Sllovene e Infrastrukturës

Teksti dhe koncepti nga

UROŠ BRUMEC, Msc. i Inxhinierisë, Agjencia Sllovene e Infrastrukturës

Shenjat arkitekturore (teksti dhe ilustrimet) nga

MATEJ ISKRAČ, Inter Punkt d.o.o.

Dizajni krijues dhe grafik, dhe realizimi nga

SONJA ERŽEN, drejtore ekzekutive, Studio Aleja d.o.o.

Ilustrimet nga

SONJA ERŽEN, u.d.i.a. dhe ITOK AMBROŽ

Versioni 2,0

LUBJANË, 29.06.2022

30
km/h



9 789617 089035 >